



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKE  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1899/2 prot.

Pukë, më 22.10.2024

V E N D I M

Nr. 51 datë 16.10.2024

**“PER MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT: “MASA PARANDALUESE TË GËRRYERJES SË TOKAVE BUJQËSORE DHE KANALEVE VADITËSE NGA UJRAT E LARTA DHE SISTEMIMI I TYRE NJESIA ADMINISTRATIVE GJEGJAN BASHKIA PUKË ” ME FONDIN E KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE”**


Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , Ligjin Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30 shkronja “gj”, VKM nr. 414 date 08.07.2021 “ Per miratimin e procedurave dhe kritereve te ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile , i ndryshuar me VKM nr. 290 date 17.05.2023, shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.446/2 Prot date 20.02.2024 ”Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, për të marrë masa parandaluese, të gerryerjes se tokave bujqesore dhe kanaleve vaditese nga ujrat e larta dhe rehabilitimi i tyre, Njesia Administrative Gjegjan, Bashkia Puke me propozim te Sektorit te Emergjencave Civile, të Drejtorise se Finances si dhe të Kryetarit te Bashkisë Pukë , Këshilli Bashkiak ne mbledhjen e tij te dates 16.10.2024, pas shqyrtimit dhe diskutimit te anetareve , ne perfundim :

V E N D O S I :

1. Të miratojë projektin me objekt: “Masa Parandaluese të gerryerjes së tokave bujqesore dhe kanaleve vaditese nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre, Njesia Administrative Gjegjan ” nga fondi i kushtëzuar i buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile, më vlerë **2300346.45 leke** , me kod produkti 91707AG , sipas shkresës nr. 446/2 datë 20.02.2024 ”Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances , Sektori i Emergjencave Civile
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

4. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.  
Vota te vlefshme gjithsej 11  
Vota pro 9 , vota kunder 1 , vota abstenim 1

SEKRETARI  
Hazbi Terbuni



KRYETARI  
Gjon **GJOKA**







07.11.24

SEC / KRM / 11 / 7  
Për mbrojtjen  
shkurtorë



1896/3  
07.11.2024  
RE SHQIPËRISE

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 734/1 prot.

Shkodër, më 07.11.2024

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 51, datë 16.10.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË ✓

PËR INFORMIM: AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE, TIRANË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut” kreu IV/1, pika 4, 5, 6, 7, 9 të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut” neni 13, shkronjat “e & p”, të ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, shkronja “f” dhe “gj”, neni 41, pika 2, të VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, të ndryshuar, pika 3.1, shkronja “b”, të VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu II, pika 2, shkronja “d”, të shkresës së MEF nr. 3806/1 prot., datë 29.03.2024 “Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për emergjencat civile, për vitin 2024”, të VKB Pukë nr. 47, datë 29.12.2023 “Për miratimin programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 dhe buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Pukë”, të ndryshuar, të shkresës së Këshillit Bashkiak Pukë Nr. 1896/3 prot., datë 22.10.2024, shqyrtoi VKB Nr. 51, datë 16.10.2024 “Për marrjen e masave parandaluese të gërryerjes së tokave bujqësore dhe kanaleve vaditëse nga ujrat e larta dhe sistemimin e tyre, NJAD Gjegan, Bashkia Pukë, me burim financimi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, me vlerë 2 300 346,45 lekë nga programi 10910 dhe kod produkti 91707AG me burim financimi nga fondet e kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për vitin 2024 për Bashkinë Pukë.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI  
Majlinda ANGONI  
REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
SHKODËR